Kronikë

Gjirokastër/ 'Andromeda' shkatërron grupin e shpërndarësve të drogës, 17 të arrestuar, mes tyre 1 doganier! Pezullohen 2 efektivë të Kakavijës (VIDEO)

Policia e Gjirokastrës jep detajet e para të operacionit, pas shumë javësh përgjime dhe hetimesh me Prokurorinë. Pesë ishin arrestuar në tetor dhe nëntor të vitit të kaluar, 12 u kapën sot, 2 prej tyre me masën arrest shtëpiak. Edhe një doganier i ndaluar. Dy kufitarëve, një prej të cilëve femër, iu gjetën drogë, para cash, dokumente false e municion

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Lajmëroni

Redaksia
19 Janar, 11:12 | **Përditësimi: 19 Janar, 16:38**

Share

A A

Gjirokastër- Një operacion i gjerë antidrogë është zhvilluar në Gjirokastër ditën e sotme (19 janar), deri tani me 17 persona të arrestuar.

Mes tyre edhe një doganier, teksa 2 efektivë të Policisë Kufitare Kakavijë që u kapën me lëndë narkotike dhe shuma të konsiderueshme monetare, pjesë e rrjetit të goditur, u pezulluan nga AMP.

Burime zyrtare bëtë me dije për Report Tv dhe Shqiptarja.com se është goditur një grup i mirëorganizuar që shpërndante kanabis e kokainë, edhe me ndlihmën e efektivëve të pezulluar nga AMP.

LEXO EDHE:
Rruga e varrezave në Këlcyrë si në mesjetë, 30 vite pa investim! Bashkia nuk 'vë dorë', banorët: Duhet ndërhyrë! Kryebashkiaku për REPORT TV: Prioritet më 2025

Gjithashtu ka edhe shumë persona të shoqëruar dhe në proces verifikimi. Operacioni është koduar "Andromeda".

> *"Operacioni, si rezultat i një hetimi disa mujor të ndjekur me metoda proaktive, Seksioni për Hetimin e Narkotikëve dhe Trafiqeve në DVP Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale në Departamentin e Policisë Kriminale, në DPPSH nën drejtimin e Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër", bëhet me dije në njoftimin zyrtar.*

Gjatë fazës së tretë u ekzekutuan masat e sigurisë për 12 shtetas, 10 prej tyre me masë sigurie "arrest në burg" ndërsa 2 me masë sigurie "arrest në shtëpi", pjesëtarë të një grupi kriminal të implikuar në shitjen e lëndëve narkotike, në qytetin e Gjirokastrës.

Ndërkohë që 5 të tjerë ishin arrestuar në datat 25 tetor dhe 13 nëntor 2024, teksa bashkëpunonin me 12 të ndaluarit ditën e sotme, të organizuar si grup, si dhe që janë të implikuar në veprimtarinë kriminale të shitjes së lëndëve narkotike, në doza, kryesisht në Gjirokastër.

Të arrestuarit janë H. H., 38 vjeç, D. O., 38 vjeç, K. G., 26 vjeç, B. C., 42 vjeç, R. Gj., 33 vjeç, dhe E. T., 35 vjeç, banues në Gjirokastër, për veprën penale "prodhimi dhe shitja e narkotikëve, kryer në bashkëpunim. I. K., 49 vjeç, E. D., 22 vjeç, E. Ç., 36 vjeç, banues në Gjirokastër, për veprën penale "prodhimi dhe shitja e narkotikëve"; si dhe Th. K., 41 vjeç, banues në Gjirokastër, për veprën penale "ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike".

Gjithashtu, u ekzekutuan masat e sigurisë "arrest në shtëpi", për shtetasit E. N., 25 vjeç dhe M. F., 23 vjeç, të dy banues në Gjirokastër, për veprën penale "kontrabanda me mallra të tjera", kryer në bashkëpunim.

> *"Në bashkëpunim me AMP, u ekzekutuan masat e sigurisë "pezullim i ushtrimit të një funksioni apo shërbimi publik", për shtetasit L. K., 32 vjeç dhe O. B., 29 vjeçe, të dy banues në Gjirokastër, me detyrë punonjës policie në PKK Kakavijë, për veprën penale "shpërdorimi i detyrës", kryer në bashkëpunim. Gjatë kontrolleve të ushtruara për të gjetur provat materiale me qëllim të dokumentimin ligjor të veprimtarisë kriminale të këtyre shtetasve, janë gjetur dhe sekuestruar shuma të konsiderueshme vlerash monetare, lëndë narkotike Cannabis dhe Kokainë, municion luftarak, celularë, automjete, dokumente të falsifikuara, malfra kontrabandë etj.", theksohet në njoftim.*

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për veprime të mëtejshme.

SI.E./E.H./Shqiptarja.com

TAG: kakavije | operacion antidroge | drogë | Gjirokaster

Komento

Komente

Ndalohet rrepëtisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
18 Janar, 08:40
A duhen bërë publik emrat e politikaneve që kanë përdorur Sky Ecc?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Tiranë/ Të dënuar për drogë, vjedhje dhe drejtim mjeti në mënyrë të parregullt, arrestohen 3 të shpallur në kërkim, mes tyre edhe një 19-vjeçar
18 Janar, 10:55

Gjirokastër/ Zjarr në një banesë, shkak dyshohet masa elektrike në aspiratorin e kuzhinës!
Piro Nase
17 Janar, 19:13

Gjirokastër/ Arrestohet ish-kryetari i komisionit për prokurimet publike në Bashkinë e Memaliajit! Akuzohet për abuzime me tenderat
17 Janar, 14:11

RENEA zbarkon në Pogradec, 6 në pranga, 28 kontrolle banesash e 207 mijë euro të kapura! Arrestohet Fatjon Bono, më herët u hetua si përkrahës i ISIS, kërkohet vrasësi i kamerierit
Sokol Dema
17 Janar, 08:14

Rrëshqitja e dherave, bllokohet aksi rrugor Ura e Dragotit-Këlcyrë
14 Janar, 14:59

Gripi Shpendëve zgjeron hartën, zbulohet një vatër e re në Gjirokastër! Mbi 20 pula janë groposur
14 Janar, 10:11

Gjirokastër/ Zjarri shkrumbon magazinën, ikën dëm edhe 1 ton raki, shkak dyshohet shkëndija elektrike
13 Janar, 13:10

Zgjedhjet e 11 majit/ Ambasadori italian: Situata shumë konfliktuale, fushata të jetë me fakte e programe! Qeveri teknike? 'Vendos politika'
Piro Nase
10 Janar, 11:21

Spanjë/ Goditje e trafikut të drogës në Vigo, 9 të arrestuar, shumica shqiptarë! Kapet 1.1 ton kokainë
10 Janar, 07:07

Media greke: Dritan Rexhepi, shqiptari që ndërtoi kartelin e kokainës, nga 'investitori' grek në 'Escobarin' e ri të perandorisë së drogës
7 Janar, 23:01

VIDEOLAJM/ Dyshime për drogë, makina e funeralit i nënshtrohet kontrollit në Portin e Vlorës
7 Janar, 21:23

Fier/ Drogë, aksident, përmbjekje dhe dhunë në familje, 8 persona nën hetim
7 Janar, 15:26

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje